



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

# Buletini

Viti I, Nr. 6

Shtator & Tetor 2004

## Konferenca vjetore e AKK-së:

# Marrëdhëniet e nivelit lokal me atë qendror Partner për progres

Më 16 dhe 17 nëntor në Prishtinë mbahet Konferenca e Tretë Vjetore të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Konferenca do të fokusohet në marrëdhëniet mes qeverisë lokale dhe asaj qendrore dhe do të marrin pjesë mysafirë nga Asociacionet e Qeverisjes Lokale të Anglisë, Uellsit dhe Maqedonisë si dhe përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë. Gjithashtu, konferenca do të përfshijë edhe prezantime të punës së Asociacionit të Komunave të Kosovës gjatë vitit të kaluar, duke bërë një përmblendje të deklaratave parimore që adresojnë gjithë çështjet kyçe të qeverisjes lokale.

Asociacioni i Komunave të Kosovës vepron si një forum për qeverinë lokale në Kosovë. Qëllimi i tij është promovimi i qeverisjes lokale, pjesëmarrjës qytetare, demokracisë lokale dhe shkëmbimit të përvojave me komuna dhe asociacione të tjera evropiane. Asociacioni mban statusin e vëzhguesit në Kongresin e Këshillit të Evropës për Autoritetet Lokale dhe Rajonale dhe është anëtar i përhershëm i Rrjetit të Asociacioneve Kombëtare të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore.

## Programi

E Hënë 15 Nëntor 2004

18:00-19:30 Pritja dhe Mirëseardhja

E Martë 16 Nëntor 2004

09:45-10:15 Regjistrimi

10:15-10:30 Mirëseardhja dhe hapja:  
Lutfi Haziri - Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)

10:30-10:45 Fjala e Kryetarit të Kosovës

10:45-11:30 Fjala e Kryeministrit të Kosovës  
Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës  
Pyetje

11:30-11:45 Pushim

11:45-13:00 Mesazhe mbështetjeje nga përfaqësues të:  
Agjencisë Evropiane për Rindertim (EAR)  
Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)  
Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)  
Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA (USAID)  
Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP)  
Shefit të Projektit të IFES Ltd.

13:00-14:30 Dreka

14:30-15:15 Marrëdhëniet mes nivelit qendror dhe lokal -  
Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale:  
Debat i drejtuar nga Z. Owen Masters -  
Shef i Zyres së Këshillit të Evropës në Prishtinë

15:15-16:00 Studim Rasti për marrëdhëniet mes nivelit qendror dhe lokal:  
a) MB: Ruth Coleman dhe Drejtori Mike Ashley -  
Byroja Ndërkombëtare e Qeverisjes Lokale  
b) Maqedoni: Asociacioni i Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale (ANjVL)

**Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës mori pjesë në Kongresin e Këshillit të Evropës të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës**

## Asociacioni i Komunave mori pjesë në Kongresin e Këshillit të Evropës të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës



Delegacioni i pushtetit lokal të Kosovës, i kryesuar nga z.Lutfi Haziri, kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës nga 3 deri më 5 nëntor ka marrë pjesë në Kongresin e Këshillit të Evropës të Autoriteteve Lokale

dhe Rajonale të Evropës që u mbajt në Strasburg. Punimet e Kongresit u zhvilluan të ndara në disa seanca, ku në pjesën e Komitetit Institucional të Odës së Autoriteteve Lokale, pjesëmarrësit ndër të tjera diskutuan edhe për statusin e kryeqyteteve, bashëpunimin ndërkomunal, konferenca “20 vjet të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale” si dhe monitorimi i demokracisë lokale. Gjatë punimeve të Kongresit në seancën e Komitetit Institucional u debatua për ruajtjen e të drejtave themelore të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale – Instrumentet e Këshillit të Evropës. Në pjesën e Komitetit të Përhershëm të Kongresit, u bisedua edhe për zgjedhjet lokale e rajonale të Evropës, ku Kongresi u informua edhe për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të mbajtura më 23 tetor.

## Pushteti Lokal i Kosovës në Konferencën “Qeverisja demokratike efektive në nivelin lokal dhe rajonal”



Organizuar nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, Këshilli i Evropës dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë në fund të tetorit në Zagreb të Kroacisë u mbajt Konferenca Rajonale Ndërmnistrore e Evropës Juglindore dhe Asociacioneve të Komunave nga shtetet e Evropës Juglindore mbi “Qeverisjen demokratike efektive në nivelin lokal dhe rajonal”, ku në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës mori pjesë drejtori ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi.

Për dy ditë më rradhë përfaqësuesit e autoriteteve lokale të Evropës Juglindore diskutuan një mori temash në efektivitetin e qeverisjes lokale me theks në rolin e mbështetjes së qeverisjes efektive demokratike në nivelin lokal e regjional dhe në atë se çfarë lloj qeverisje lokale duam në vitin 2010.

Poashtu kjo konferencë nxorri një deklaratë e cila në mënyrë të qartë përfshijë vizionin dhe lidhshimin, vetëqeverisjen lokale, legjislacionin, bashkëpunimin ndërkufitar, burimet dhe kapacitetin si dhe partneritetin e transparencën e qeverisjes lokale dhe asaj qendrore. Kjo deklaratë pritet që pas konsultimeve do të nënshkruhet nga përfaqësuesit e Autoriteteve Lokale dhe atyre Qendrore. Në këtë Konferencë janë aprovuar edhe planet dhe projektet për periudhën e ardhshme të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore ku edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës ka bërë prezentimin e planeve për të ardhmen.

**Përfaqësuesit e komunave të Kosovës, në Ohër diskutuan për**

## ANALIZAT DHE PËRGATITJA E BUXHETEVE NGA PERSPEKTIVA GJINORE

Organizuar nga **Asociacioni i Komunave të Kosovës** dhe **World Learning Star Network** për disa ditë më rradhë në Ohër u debatua për analiza dhe përgatitja e buxheteve të ndihshme nga perspektiva gjinore. Pjesëmarrës ishin zyrtarët për Çështje Gjinore dhe drejtorët e Drejtorive për Buxhet e Financa të Kuvendeve Komunale të Kosovës si dhe përfaqësues të OJQ-ve që merren me çështje gjinore. Në këtë takim u diskutua temat si kuptimi i buxheteve llojet dhe

funksionimi i tyre, funksionimi i buxhetit të Kosovës dhe hallkave vendimarrëse, problemet që hasen në hartimin dhe analizën e buxheteve sipas perspektivës gjinore, kufizimet e përdorimit të iniciativave të buxheteve, instrumentet e buxhetimit, strategjitë për ndërmarrjen e analizave të buxhetit për çështje gjinore etj.

Zyrtarët për çështje gjinore dhe ata për Financa e Buxhet të komunave të Kosovës punuan në grupe të ndryshme, ku në grupin e parë, nga **4 - 6 nëntor** mor-

rën pjesë përfaqësuesit nga Kamenica, Gjilani, Novoberda, Podujeva, Fushë Kosova, Klina, Deçani, Suhareka, Skenderaj dhe Dra-gashi, në grupin e dytë, nga **8 - 10 nëntor** përfaqësuesit nga komuna e Vitisë, Kaçanikut, Obiliqit, Drenasit, Istogut, Vushtrrisë, Malishevës, dhe Rahovecit dhe në grupin e fundit, nga data **11 - 13 nëntor** për të diskutuar në këtë temë ishin përfaqësuesit nga komunat Ferizaj, Prishtina, Lipjani, Shtime, Gjakova, Mitrovica, Prizreni, dhe Peja.

**Klikoni** në web-faqen e Asociacionit të Komunave të Kosovës

# www.komunat-ks.net

new  
new  
new

Në kuadër të aktiviteteve të saja dhe të komunikimit me opinionin e jashtëm dhe të brendshëm Asociacioni i Komunave të Kosovës tashmë ka edhe faqen e saj zyrtare në internet **www.komunat-ks.net** e cila është ndërtuar me shtrirje dhe me informacione të ndryshme e të shumta.

Në web-faqen e AKK-së do të gjeni dokumentet themelore të Asociacionit të Komunave të Kosovës, strukturën organizative, informacionet rreth aktiviteteve në Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare, partnerët, komisionet e AKK-së, një numër i konsiderueshëm të fotove nga aktiviteti -në fotogaleria etj.

Në këtë faqe do të gjeni të gjitha Rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligjet e Parlamentit të Kosovës si dhe rezultatet e zgjedhjeve lokale 2000 dhe 2002 në Kosovë si dhe janë vendosura linqet e komunave të Kosovës, institucioneve vendore qendrore të Kosovës e organizatave të jashtme, linket e mediave kosovare dhe të huaja etj.

Publikimet janë të vendosura edhe në programin PDF dhe ato mund të shkarkohen shumë lehtë.

Web-faqja e AKK-së është punuar në tri gjuhë shqipe, angleze dhe atë serbe.

**Web-faqja e Asociacionit të Komunave të Kosovës Ju ofron publikimet e saja si Buletini, Prospektin e AKK-së, hulumtimin për standardet si dhe të gjitha Deklaratat Parimore.**

**Pas sulmit fizik në Serbi**

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS DËNON SULMIN FIZIK NË BEOGRAD NDAJ KRYETARIT TË DERITASHËM TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS

Asociacioni i Komunave të Kosovës dënoi ashpër aktin e sulmit fizik në Beograd ndaj Kryetarit të deritashëm të Kuvendit Komunal të Shtërpcës z.Sllagjan Ilic ku atij i janë shkaktuar lëndime fizike e dëme materiale në veturën e tij. Asociacioni i Komunave të Kosovës si përfaqësues i interesave të komunave të Kosovës konsideron se aktet e tilla të sulmeve fizike ndaj njerëzve të zgjedhur nga vota e qytetarëve nuk e ndihmojnë demokracinë dhe stabilitetin në rajon - thuhet në reagimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) nënshkruar nga kryetari z.Lutfi Haziri.

Dhunën fizike ndaj ish-kryetarit të komunës së Shtërpcës e ka dënuar edhe kryeministri i Kosovës, z.Bajram Rexhepi.

<p>ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS</p> <p><b>BULETINI</b></p> <p>Viti I, Nr. 6 - Shtator &amp; Tetor 2004</p> <p>Bordi Botues: Sazan Ibrahim, Arsim Osmani, Mexhit Shaqiri, Merita Krasniqi</p> <p>Rr.Isa Kastrati, Nr.113 Tel&amp;Fax: 038 / 245 - 734 komunat_akk@hotmail.com</p> <p>Asociacioni i Komunave të Kosovës mbështetet nga Agjensioni Evropian për Rindërtim përmes projektit "Përkrahje decentralizimit në nivelin komunal", implementuar nga IFES Ltd.</p>	  <p>Statusin e Vëzhguesit</p>	 <p>Asociacioni i Komunave të Kosovës Association of Kosovo Municipalities Asociacija Kosovskih Opština</p>	  <p>Anëtar i përhershëm</p>
---	--	---	--